

VENDIM
Nr.47, datë 14.10.2004

PER PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
KOMPANIA “JUANA” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.9072 datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 8 pika 2 germa b dhe neni 26, Bordi Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 14.10.2004, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga kompania “Juana” sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike dhe relacionin e Departamentit të Tarifave dhe të Çmimeve, mbi bazën e një analize të hollësishme të kostos :

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga kompania “JUANA” sh.p.k. për periudhën 1.1.2004 – 31.12.2004, të jetë 4,55 lekë/kWh.
2. Ngarkohet kompania “Juana” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema